



## **STATUTI**

### **I**

## **SHOQERISE "VELA GROUP" Shpk**

### **KREU I**

#### **Forma ligjore, emertimi, selia e shoqerise.**

#### **Neni 1**

##### **Forma juridike**

Ne mbeshtetje te vullnetit te Ortakeve te shoqerise, si dhe ne pajtim te plote me dispozitat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, neni 68 dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Shoqeria Tregtare "Vela Group" Shpk, formohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe e cila do te funksionoje sipas dispozitave te këtij statuti dhe aktit të saj të themelimit.

#### **Neni 2**

##### **Objekt veprimtarie të Shoqërisë:**

Shoqëria ka si objekte veprimtarie të saj aktivitetet që paraqiten në vijim:

- Kryerjen e aktivitetit të formimit dhe edukimit profesional në fushën e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikacioneve, përgatitje, zhvillim, shitje dhe blerje programesh kompjuterike, dhe aktivitete te tjera te lidhura me ekonominë Digjitale.
- Shërbime për zhvillim programesh, stafesh te specializuara ne fushën e TIK dhe Inovacionit.
- Aktivitet në fushën e prodhimit, blerjes dhe shitjes se software (programeve kompjuterike dhe zgjidhjeve teknologjike nëpërmjet programimit), dizenjim programimi (kodim) dhe zhvillim, projektim i detajuar i software dhe bazave të të dhënave, analizë, integrim i përbërësve (komponenteve), trajnime mbi produktet software, instalime, konsulenca, zbatime dhe aktivitete te tjera ndihmëse ne fushën e teknologjisë dhe digjiitalizimit përtej industrisë përkatëse, ndjekje te proceseve, kolaudim, korrigjim, deri ne produktin përfundimtar duke realizuar zgjidhje, plotësime te sistemit informatik me elementet e sigurisë, privatësisë etj.
- Blerje dhe shitje të pajisjeve hardware, kompjutera, aksesore dhe pjesë të tyre, instalim e mirëmbajtje te tyre.
- Kurse te formimit profesional, këshillim karriere, ndërmjetësim punësimi dhe shërbime të tjera të tregut të punës te lidhura kryesisht me fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë, por dhe më gjerë, në sektorë të tjerë përtej kësaj industrie.
- Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtën e lidhjeve profesionale midis punëdhënësve të lidhur me fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe më gjerë si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Import dhe eksport të mallrave dhe shërbimeve sipas nënpikave a.-f. te këtij neni.
- Krijimin, këshillimin, dhe financimin e sipërmarrjeve të reja (startups).

*[Handwritten signatures and notes at the bottom of the page]*



- Blerje pjesëmarrjeje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të tjera, ente konsorciume, të themeluara apo në themelim, të cilat mund të kenë objekt të ngjashëm ose sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes të qëllimit të shoqërisë.
- Shoqëria mund të beje ose mund të kërkojë regjistrimin në emër të saj, transferoje apo të tregtoje si të njëjta, patenta e të drejta autori, marka të ndryshme, marketingu, licenca, tituj tregtie si dhe të drejta të ngjashme intelektuale dhe industriale.
- Më në përgjithësi shoqëria do të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë

### **Neni 3 Emertimi**

Emertimi i shoqërisë do të jetë **“Vela Group” Shpk**

### **Neni 4. Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

### **Neni 5 Selia, Agjencite dhe Zyrat e Perfaqesimit**

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa 203, H.11, 1023, Laprakë, Tiranë, Albania**

- (1) Adresa e Faqes së Internetit të Shoqërisë është: **www.holberton.al**
- (2) Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon **info@holberton.al**

Veprimtaria e shoqërisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët dhe agjencitë e saj, të cilat funksionojnë në rrethë apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë dhe administratorit.

Shoqëria mund të krijojë degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato krijohen dhe prishen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## **KREU II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT NDRYSHIMET E KAPITALIT**

#### **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga shuma prej 86 000 ALL (Tetëdhjetë e gjashtëqind mijë leke shqiptare). Ai është i ndarë, në 5 Kuota për çdo Kuotë të

shlyer për teresine e vleres nominale të tyre. Kuotat janë të numeruara nga 1 deri 6. Ortaket e shoqërisë janë:

- **'A'**, **Ilir Mitrushi** i biri i Mirilit, i datëlindjes 17.06.1966, i cili zoteron 1 Kuotë me 9.3% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 7.998 lekë.
- **'B'** **Dritan Vreshta**, i biri i Sami i datë lindjes 10.06.1977, i cili zoteron 1 Kuotë me 9.3% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 7.998 lekë.
- **'X'** **Russell Grant Van Cleve**, i biri i Russell, i cili zoteron 1 Kuotë me 29.07% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 25.000,2 lekë.
- **'Y'** **Migena Schröder**, e bija e Lefter Klemo, e datë lindjes 28.05.1975, i cili zoteron 1 Kuotë me 29.07% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 25.000,2 lekë.
- **'Z'**, **EUROCON blue GmbH**, rregjistruar në Kiel, Gjermani me nr identifikim HRB 15108 KI, me adres Im Brauereiviertel 5, 24118 Kiel, Gjermani; i cili perfaqësohet nga Axel Joerg Schulz, i biri i Harald Otto Gustav Schulz, i datë lindjes 12.04.1968, i cili zoteron 1 Kuotë me 23.26% në kapitalin themeltar të shoqërisë me një shumë në vlerë prej 20.003,6 lekë.

#### Neni 7

##### Forma e Kuotave

Kuotat e Shoqërisë janë të zakonshme nominative.

Pronesia e Kuotave vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarëve në QKB.

Kuotat janë të pandashme. Me marrëveshje të vecante midis ortakëve kuota mund të ndahet.

#### Neni 8


##### Shitja dhe transferimi i Kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b. Shit-blerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj;

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Përveç rastit të trashëgimise, transferimi i pronësive mbi Kuotat e një te treti, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të miratohet nga Asambleja e Ortakëve në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara në nenin 73 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



Ne qofte se Asambleja ka refuzuar shitjen e kuotave nje bleresi qe nuk eshte ortak, shitesi duhet te njoftoje shoqerine me leter rekomande brenda 8 diteve nga data e njoftimit te realizimit, nese ka hequr dore nga projekti i shitjeve te Kuotave. Ne rast se shitesi nuk ka hequr dore nga ky projekt, asambleja duhet te siguroje blerjen e Kuotave prej nje ose disa persona te zgjedhur prej tij.

Ne qofte se, per vleresimin e Kuotave nevojitet nje akt ekspertimi, shpenzimet paguhen pergjysem te ndara midis shitesit dhe bleresit. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontratës.

### Neni 9

#### Zmadhimi i kapitalit themeltar dhe shperndarja e fitimit

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet, sipas menyrave dhe rregullave te parashikuara ne nenet 168 ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, nËpËrmjet nËnshkrimeve tË pjesËve tË kapitalit themeltar pËr kontributet nË para dhe me anË tË kontributeve nË natyrË, nËpËrmjet emerimit nga gjykata kompetente e nËj eksperti tË autorizuar pËr kËto kontribute sipas kËrkesËs sË administratorit.

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se ortakeve, ne baze te raportit te drejtorise, te hartuar ne menyren e kerkuar nga ligji me mË shumË se 69% te votave.

Kjo e drejte eshte ne perpjestim me shumen e kuotave te zoteruara nga ortaket perpara zmadhimit te kapitalit.

Ortaku mund te heq dore nga e drejta per nenshkrimin e kuotave te reja. Ai, gjithashtu, ka te drejte te kerkoje nenshkrimin e nje numri me te vogel kuotash nga sa i takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe Asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete gje.

Shoqeria do te shperndaje dividend ne perputhje me kerkesat e nenit 77 te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

### Neni 10

#### Shlyerja e Kuotave

Kuotat per kapitalin jo ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit me kontribut ne natyre (pasuri tË luajtshme/tË paluajtshme apo tË drejta) duhet te paguhen teresisht perpara regjistrimit, nepermjet kalimit ne favor te shoqerise te titullit te pronesise se kontributit ne natyre. Nese, sipas ligjit, kerkohet kryerja e formaliteteve te posacme per regjistrimin e kalimit te titullit te pronesise te kontributit ne natyre, keto formalitete kryhen nga perfaqesuesit ligjore te shoqerise. Kontributi ne natyre do te konsiderohet i paguar ne castin kur ortakut te kete kryer te gjitha veprimet dhe te kete nenshkruar te gjitha aktet e kerkuara nga ligji per kalimin e titullit te pronesise se kontributit ne emer te te shoqerise.

OrtakËt i vlerËsojnË kontributet nË natyrË nË marrËveshje tË ndËrsjella me nËjËri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre nË para. NËse nuk mund tË arrihet nËjË marrËveshje, ata



mund të vendosin bashkerisht, ose secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Pjesa tjetër e vlerës së kuotës që kontribohet në para do të shlyhet njeherësh ose me keste, në baze të kerkimit për shlyerje nga asambleja brenda një afati 3 vjet nga data kur zmadhimi i kapitalit është kryer perfundimisht.

Asambleja e Pergjithëshme që vendos zmadhimin e kapitalit, ka të drejtë të marrë vendimin për shlyerjen teresore të kuotave që në castin e nenshkrimit ose brenda një afati me të shkurtër, nga ai i përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkruësve të paktën 15 dite përpara datës së caktuar për çdo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar çdo pronari të kuotave.

Çdo vonesë në derdhjen e shumave të kërkuara sjell pagimin e interesave sipas përqindjeve të caktuara me ligj, duke filluar nga data e kerkimit të çdo derdhjeje pa qenë nevoja për të proceduar në formalitete të tjera të çfaredoshme dhe pa hequr dorë nga veprimet e Shoqërisë ndaj Ortakëve të detyruar dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga ligji.

#### Neni 11

#### Burimet të tjera të financimit

Shoqëria preveç kontributeve të kapitalit nga ortakët e saj mund të perdore dhe çdo burim tjetër financimi të fituar në përputhje me kërkesat e legjislativës në fuqi. Ortakët X, ortaku Y dhe ortaku Z do të japin një financim në formën e huas përkatësisht në një shumë minimale prej 60,000 USD (dolare amerikane, \$), ortaku Y prej 60,000 USD, ortaku Z prej 60,000 USD dhe ortaku B prej 6,000 USD. Ky financim do të jepet kundrejt nenshkrimit të kontratës përkatëse midis tyre dhe shoqërisë dhe me norma të interesit sa intere i kreditorëve me 5 përqind në vite. Shuma e këtij financimi mund të kërkojë me pjesë bazuar në nevojat e shoqërisë për fonde për funksionimin e saj, dhe do të jetë me afat 40 muaj. Shoqëria nuk mund të shpërndajë dividende nga fitimet e saj, pa shlyer me parë detyrimet ndaj këtyre ortakëve për financimin e marrë prej tyre ose pa marrë me parë pëlqimin e të paktën 69% të ortakëve.

Nëse ortakët X, Y, nuk e plotësojnë detyrimin e tyre, atëherë ata detyrohen të heqin dorë nga 4/5 të kuotës së tyre të kapitalit të tyre në përpjestim me mosplotësimin e këtij detyrimi, duke ja transferuar këto pjesë të kuotës së tyre shoqërisë me vlerën nominale.

Nëse ortaku Z, nuk e plotëson detyrimin e tij për të dhënë shumën e financimit, atëherë ai detyrohet të heqë dorë nga e gjithë kuota e tij e kapitalit të tij në përpjestim me mosplotësimin e këtij detyrimi për dhenien e huas, duke ja transferuar këto pjesë të kuotës së tyre shoqërisë me vlerën nominale.

*(Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page, including a signature with the number 5 next to it.)*



## Neni 12

### Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise kryhet vetem me Vendim te Asamblese te Pergjitheshme te Ortakeve dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 80 dhe 81 te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar. Zvogelimi i kapitalit themeltar nuk duhet te cenoje raportet e ortakeve para ketij zvogelimi. Zvogelimi i kapitalit mund te ndodhe edhe ne rastin kur asamblea e ortakeve vendos qe kuotat apo pjeset e tyre te nje ortaku te anulohen. Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen shumen minimale te kerkuar nga ligji.

## Neni 13

### Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me kuotat

Cdo kuote jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet vjetore te shoqerise te destinuar per shpendarje dhe ne tepricen e aktivitetit te mbetur ne rastin e likuidimit, ne perpjestim me perqindjen qe zoteron ne kapitalin themeltar.

Pronesia mbi kuotat jep edhe te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne mbledhjet e Asamblese se Pergjitheshme ne kushtet e percaktuara ne ligj dhe ne statut. Ortaket pergjigjen per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Ndalohet kerkimi i fondeve te kesaj shume.


Kur kuotat u kalojne ortakeve te rinj, keta ruajne te drejtat e detyrimeve qe vijne nga kuotat.

Pronesia e nje kuote permban automatikisht te drejten e aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e Asamblese se Pergjitheshme.

Shoqeria fiton te drejten e riblerjes se kuotave te Ortakeve A dhe B ne masen 1/40 per cdo muaj bazuar ne performancen e angazhimit te marre nga keta ortake ndaj shoqerise, perkatesisht ortaku A ne rolin e administratorit dhe perfaqesuesit ligjor, si dhe drejtuesit akademik dhe pedagogjik te shkolles, kurse ortaku B do te kryeje rolin e drejtuesit operativ te shkolles. Vleresimi i performances se ortakeve A dhe B do te behet ne menyre periodike dhe do te jete asamblea e ortakeve te shoqerise qe do te vendose ne lidhje me terheqjen apo jo nga kuotat e kapitalit te secilit prej ketyre ortakeve. Asambeja do te vleresoje performancen e tyre gjate nje periudhe 40 mujore. Ortaket A dhe B do te heqin dore nga e drejta e gjithë kuotes se tyre pjeserisht apo plotesisht duke e kaluar ne favor te shoqerise ne masen prej 1/40 per cdo muaj, bazuar ne vleresimin periodik qe do te beje asambleja e ortakeve per performancen e punes se tyre. Ne rast se ortaku A dhe B nuk plotesojne detyrimin e tyre sipas percaktimit ne kete nen atehere ata kane detyrimin dhe shoqeria ka te drejten e blerjes se kuotes se tij me vleren nomonale. Shuma e kapitalit qe do te heqe dore ortaku A dhe B llogaritet pas vleresimit te asamblese me 1/40 e cdo muaji qe ka mbetur nga periudha 40 mujore e angazhimit te tyre.

Nese asambleja nuk shprehet ne menyre te drejtperdrejte atehere vleresohet performanca pozitivisht ne heshtje. Riblerja do te behen ne rast se ortaku A apo B nuk plotesojne angazhimet e marra ne lidhje me aktivitetin qe do te kryeje prane shoqerise dhe qe percakton edhe te drejtat e tij si ortak. Me riblerjen e kuotes ose te

*[Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page.]*



pjeses se kuotes nga ana e shoqerise si me siper ortaku humbet te gjitha te drejtat e tij si i tille ose vijon te mbetet ortak ne masen qe asambleja vlereson qe ka fituar te drejtat si ortak. Kuotat e riblera do te jene ne pronesi te shoqerise dhe mund te perdoren ose ne rast shitjeje se nje apo disa ortakeve ekzistues ose te rinj ose mund te anulohen duke u mbuluar perpjestimisht nga ortakët ekzistues. Keto kuota te riblera nuk kane te drejte vote per sa kohe qe nuk jane emetuar. Kjo e drejte e shoqerise perfundon me mbarimin e afatit 40 mujor nga data e njohjes se te drejtave te tyre si ortake te saj.

**KREUIII**  
**ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMAMARESE**


**NENI 14**  
**Organet drejtuese**

Asambleja e Përgjithsme e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithsme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë e ndarjen e fitimeve;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. Investime ne aktive te lujtshme apo te palujtshme qe kapin vlera vecmas mbi \$20,000 (njetzet mije United States dollars - USD)
- n. shitje te aktiveve te lujtshme apo te palujtshme te shoqërisë të cilat individualisht apo së bashku kapin vlerën mbi \$20,000 (njetzet mije United States dollars - USD)
- o. Marjen e financimeve ne formen e huave nga ortakët e shoqerise.
- p. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e Përgjithsme vendos me dy të treta e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit Per tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare , për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.





Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe në statut, për çështjet e tjera të renditura në këtë nen, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga asambleja regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c. Investime;
- d. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të

## Neni 15

### Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 83 të ligjit Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të totalit të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

*[Handwritten signatures and initials]*



5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të totalit të akteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## Neni 16

### Kuorumi

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të vlerave të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 17

### Mënyra e thirrjes dhe e zhvillimit të mbledhjes së asamblesë

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti ose sipas nenit 83 të ligjit, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Asambleja mund të mbahet edhe jashtë selisë së Shqipërisë por Brenda territorit të Shqipërisë. Mbledhja e asamblesë mund të zhvillohet, në perputhje me nenin 88 të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, edhe me anë të mjeteve të telekomunikimit (skype, web, etj të ngjashme) duke respektuar metoden e kolegjalitetit, të identifikimit të ortakëve, të besimit të mirë

9

dhe të barazisë në trajtimin e ortakëve ashtu si përcaktohet edhe në nenin 88 të ligjit Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

3. Ortaku merr pjese vetë ose ai mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi të lëshuar prej tij. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal, menyra e mbajtjes dhe ruajtjes së të cialve duhet të jetë sipas sipas kereksave të nentit 90 të ligjit Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare, I ndryshuar. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

#### Neni 18

##### **Përgjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### **ORGANI ADMINISTRATIV**

#### Neni 19


##### **ADMINISTRATORËT Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme emëron si administratorë të shoqërisë si me poshte vijon:

- a. Administrator i përgjithshëm emërohet **Ilir Mitrushi**. Afati i emërimit është 5 vjet nga dita e regjistrimit në QKB, me të drejtë ripërtëritjeje.

2. Sipas rrethaneve që krijohen, shoqëria mund të emërojë edhe më shumë se një administratorë. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:





- a. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit; (administrator i përgjithshëm)
- g. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- h. Marrin vendime për krijimin e adresave secondare të biznesit të shoqërisë, për hapjen dhe mbylljen e degeve të reja të shoqërisë Brenda dhe jashtë vendit, të zyrave të perfaqësimit dhe regjistrimit të tyre në organet përkatëse duke u pajisur me NIUS sipas ligjit. Hapja e degeve apo filialeve të reja jashtë vendit kërkon që të merret vendimi me votim të thjeshtë i asamblesë së ortakeve.
- i. Investime dhe shitje të aktiveve deri në \$20,000 (nëzet mijë United States dollars - USD)
- j. Shitje të aktiveve të lujtshme apo të palujtshme të shoqërisë të cilat individualisht apo së bashku kapin vlerën deri në \$20,000 (nëzet mijë United States dollars - USD)
- k. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.


4. Në rastet e parashikuara nga ligji për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare apo ligje të tjera, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblesë të përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Pas miratimit të këtij Statuti, përgatiten rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, të cilat mund të parashikojnë vecoritë për detyrat e çdo administratori.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 20 Përfaqësimi



1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

2. Administratori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë tregtare në mardhenie me të tretet. Vetëm ai mund të autorizojë njerin prej administratorëve të tjerë, kur ka të tillë, për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.

Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 21  
Shpërblimi**

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t’i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

**Neni 22  
Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

Administratori/ët i kryjnë detyrat e tyre në zbatim të kërkesave të ligjit për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare për besnikërinë dhe përgjegjësinë. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas këtij ligji, administratorët detyrohen:

- a. të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b. të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj, në statut ose rregullore vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d. të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e. të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të ligjit;
- f. të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

12

Nëse administratorët vepronë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas përcaktimeve të bëra në paragraphët me lart të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'idëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a. u kthejnë ortakëve kontributet;
- b. u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c. u shpërndajnë aktivet e shoqërisë;
- d. lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. japin kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Për paditë që mund të jenë ngritur bazuar në parashikimet e bëra në paragraphët e këtij neni zbatohen dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

### Neni 23

#### Dorëheqja e administratorit

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nepërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblese së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të therrë asamblet e përgjithshme për emerimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emerimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendres Kombëtare të Biznesit së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblese së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj, sipas ligjit Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.



#### KREU IV

##### Kontrolloret e pavarur Audituesi Ligjor

##### Neni 24

##### Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e ortakeve te shoqerise cakton 1 auditues ligjor te pavarur nga listat e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ne caktimin e kontrolloreve te pavarur mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtushmerite e percaktuara nga ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe prej nje viti, qe i pergjigjet nje viti financiar.

Eksperti eshte i riemerushem deri 7 vjet radhazi.

Shperbimi i kontrolloreve te pavarur caktohet nga adminsitratori në përputhje me kërkesat ligjore, miratohet nga Asambleja e Ortakeve kur miraton raportin e audituesit ligjor dhe perballohet nga shoqeria.

Shoqeri tregtare "**Vela Group**" Shpk do te kete si auditues ligjor Znj. Florion Mara, Kontabilist i Miratuar, Nipt K72205004P. Adresa Rruga Astrit Balluku, Nd.2, H.3, Zyra 2, kati II, Tirane.

##### Neni 25

##### Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e kontrolloreve te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligji 10091 date 05.03.2009 "Per auditimin dhe mbajtjen e llogarive" i ndryshuar.

Asambleja e ortakeve te shoqerise mund t'u kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve te posacme per ceshtje me interes te shoqerise. Audituesit ligjor thirren ne mbledhjen e drejtorise qe mbyll llogarite e vitit financiar si dhe mund të thëriten edhe ne Asamblete e Ortakeve. Me marrjen e raportit te audituesit ligjor Asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqerise. Raportet qe ata pergatitin depozitohen ne seline e shoqerise dhe ne organet shtetore e QKB, ne afatet e parashikuara nga ligji.

#### KREU V

##### PASQYRAT FINANCIARE VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

**Neni 26**  
**Viti financiar**

Shoqëria përgatit cdo vit financiar llogarite vjetore në pajtim me ligjin Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 27**

**Caktimi i rezultateve dhe publikimit Pasqyrave Financiare vjetore**

Rezultati i viti financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dhenies së raportit perfundimtar nga audituesi ligjor.

Në përputhje me kërkesat e nenit 22 dhe 46 të ligjit Për Qendrën Kombëtare të Biznesit pasqyrat financiare duhet të regjistrohen në QKB brenda 30 ditëve nga miratimi i tyre por jo më vonë se data 31 korrik e vitit pasardhës të vitit financiar që raportohet në këto pasqyra.

**KREU VI**  
**PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDERSHTIMET**

**Neni 28**

**Prishja, likuidimi**

Shoqëria mund të priset sipas parashikimeve të nenit 99 të ligjit Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Në rastin e prishjes të shoqërisë me vendim të asamblesë të ortakëve një ose disa likuidatore emerohen nga Asambleja e ortakëve të shoqërisë.

Likuiduesi përfaqëson shoqërinë. Ai ka kompetencën të plotë për të realizuar aktivitetet e shoqërisë, të shlyejë kreditorët dhe të shpërndajë mbetjen e disponueshme ortakëve.

Ndarja e aktivitetit neto që mbetet pas rimbursimit të nominalit të kuotave bëhet midis ortakëve në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

**Neni 29**

**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar

**Neni 30**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar , Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.


#### Neni 31

##### **Zgjidhja e mosmarreveshjeve**


Te gjitha mosmarreveshjet gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likuidimit te saj qe lindin midis shoqerise dhe ortakeve ose midis vete ortakeve, lidhur me veprimtarine e shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

#### Neni 32

Ky statut perpilohet ne 4 kopje te barabarta. Perverc neneve te ketij statute, jane te detyruesheme te zbatohen edhe kerkesat e tjera te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe ligjet e tjera te shtetit shqiptar qe rregullojne bashkepronesine.



16





ORTAKET THEMELUES  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Vela Group" Sh.p.k



'A' Emer mbiemer ILIR MITRUSHI

Firm

'B' Emer mbiemer Dorian Vella

Firm

'X' Emer mbiemer Rumen Grant Van Cusen

Firm

'Y' Emer mbiemer Migena Schroedel

Firm

Pr Shoqerine Eurocon blue GmbH

'Z' Emer mbiemer Axel Schuck

Firm

Perkthyes  
Maryana Doda



Arber Ademi



17



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ANILA K. GJERMENI**  
**ADRESA NR.7, BLV"GJERGJ**  
**FISHTA", NR.4**  
**TEL: 682060214**

# **VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE**

**(VËRETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)**

**Nr. repertori: 2647**

**Tirane më 10/09/2021**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021050290217332960

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ANILA K. GJERMENI**



V2021050290217332960



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 10.09.2021, para meje Notere ANILA K. GJERMENI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV" GJERGJ FISHTA", NR.4, u paraqiten personalisht:

**NËNSHKRUESI:**

ILIR MITRUSHI, atësia MIRIL, amësia SOFIKA, shtetas Britanik, lindur në BERAT dhe banues në KORÇE, me adresë Rruga :Evanthi Dvorani, lindur më 17/01/1966, gjendja civile "I MARTUAR", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte angleze nr. 527342724 , .

**NËNSHKRUESI:**

Dritan Vreshta, atësia Sami, amësia Nigjare, shtetas Shqiptar, lindur në Pulahë, Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Elbasanit Pall.'fratari'; Nd. .; H. 3; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 10/06/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034343208 dhe nr. personal H70610057M , .

**NËNSHKRUESE:**

MIGENA SCHRÖDER, atësia LEFTER, amësia LILJANA, shtetase Gjermane, lindur në TIRANE dhe banues në TIRANE, me adresë Zug, Zvicer, lindur më 28/05/1975, gjendja civile "E MARTUAR", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me karte identiteti gjermane nr.L1CC4Y76Z , .

**NËNSHKRUESI:**

RUSSWLL GRANT VAN CLEVE, atësia RUSSELL, amësia Fusha\_MemesiPale, shtetas Amerikan, lindur në OHIO , USA dhe banues në CALIFORNIA, USA, me adresë California, Usa, lindur më 30/12/1968, gjendja civile "-", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte amerikane nr. 597459931 , ne prani te perkthyesit te gjuhes angleze Arber Ademi .

**NËNSHKRUES:**

Shoqëria EUROCON BLUE GMBH, regjistruar me numër unik identifikimi të subjektit NIUS HRB15108KI, me seli në adresë Im Brauereiviertel 5, 24118, Kile, Gjermani, përfaqësuar nga Administratori AXEL JOERG SCHULZ, atësia HARALD OTTO GUSTAV, shtetas Gjerman, lindur në KIEL, GJERMANI dhe banues në KIEL , GJERMANI, me adresë Kiel, Gjermani, lindur më 12/04/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte gjermane nr. C1KV8TMLN., ne prani te perkthyesit te gjuhes gjermane Nevjana Dosti .





V2021050290217332960

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Kontraten Themelimi e Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar "Vila Group" SHPK se bashku me Statutin e shoqërise "Vila Group "SHPK .", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**ANILA K. GJERMENI**